



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 3892/1 Prishtinë 14.11. 2022

**PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER**

**DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK**

Studenti **Gazmend Paçarizi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Mirusha, Malishevë** " në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**Abstrakti**

Qëllimi i këtij punimi është analiza e vërshimeve që po ndodhin në komunën e Malishevës dhe masat që duhet të ndërmerren më qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet.

Njeriu duke e shfrytëzuar tokën përmes ndërtimeve afër lumit, eksploatimit të pa kriter të shtretërve të lumenjve dhe hudhjes së mbeturinave në lumenj, ka ndikuar që të rritet shpeshësia dhe magnituda e vërshimeve, viteve të fundit.

Një faktor tjetër me shumë rëndësi është edhe ndryshimi i klimës, viteve të fundit, me ç'rast po paraqiten më shumë thatësi dhe reshje ekstreme si pasojë e ngrohjes globale.

Në këtë punim, kam përdorur literaturën për lumenjtë dhe vërshimet që ndodhin nga ta.

Kam përshkruar gjendjen hidrologjike të komunës së Malishevës, definicionin për lumenjtë, reshjet, matjet hidrometrike dhe pastaj kam arritur në pjesën e modelimit, ku së pari kam bërë matjet gjeodezike për sipërfaqen vërshuese për segmentin e lumit që e kam trajtuar.

Pastaj duke u bazuar në prurjet maksimale të lumit Mirusha, kam bërë analizën e prurjeve maksimale shumëvjeçare me metodat e Gumbel-it, Pearson-it, log Pearson-it, metodën normale dhe log normale, ku sipas rezultateve, për modelim hidraulik, kam marrë parasysh prurjen maksimale 50 vjeçare me vlerën më të madhe nga këto metoda, përkatësisht nga metoda log normale me vlerë  $Q_{maks} = 34.73 \text{ m}^3/\text{s}$ .

Prurjen maksimale 50 vjeçare e kam futur në HEC RAS ku kam bërë modelimin hidraulik të vërshimeve për segmentin e trajtuar dhe sipas rezultateve, është përcaktuar që ana e majtë në kahje me rrjedhjen e ujit, është më e rrezikuar nga përmblytjet si pasojë e relievit më të rrafshët dhe numrit më të madh të vendbanimeve.

Duhet pasur parasysh mungesën e të dhënave hidrologjike nga instituti hidrometeorologjik i Kosovës, ku është hasur vetëm një e dhënë e prurjes maksimale për lumin Mirusha.

Në përfundim të këtij punimi, konkludojmë se mbrojtja nga vërshimet për komunën e Malishevës nga vërshimet e lumit Mirusha, është ende e vogël dhe duhet të rregullohet shtrati i lumit që i përballon këto prurje, të mos ndërtohen objekte afër shtratit të lumit dhe së bashku me qytetarët të krijohet vetëdija që ta ruajnë pastërtinë e shtratit të lumit duke mos hedhur mbeturina.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.